

PROJEKTI PËR KONKURENCË LOKALE DHE RAJONALE

**LISTA PËR VERIFIKIM TË PLANIT TË MENAXHIMIT ME
MJEDISIN JETËSOR**

NËNPROJEKT

**RIKONSTRUIM DHE MBINDËRTIM I SHTEGUT PËR KËMBËSORË -
ÇIKLIZËM DHE VENDPUSHIM**

SEKTORI QENDËR ZHUPË – ISHUJT E DIBRËS

KOMUNA QENDRA E ZHUPËS,
VITI 2018.

) HYRJE

Projekti për konkurrencë lokale dhe rajonale (PKLR) është operacion investues financiar katërvjeçar i financuar me dotacion nga Bashkimi Evropian (Komponenta IPA2), me qëllim të nxitjes së konkurrencës dhe inovacioneve në Maqedoni. PKLR do të menaxhohet si fond hybrid dhe përbëhet prej katër komponenteve, që do të realizohen nga Banka Botërore në Republikën e Maqedonisë. Projekti do të mundësojë financim investues dhe ngritje të kapaciteteve si mbështetje për rritjen e sektorit, investime dhe prosperitet në destinacione konkrete. Në nivel lokal dhe rajonal, projekti do të mundësojë përkrahjen e destinacioneve të përzgjedhura në vend, nëpërmjet kombinimit të ndihmës teknike për përmirësimin e menaxhimit me destinacionin, investimeve në infrastrukturë, si dhe investime për lidhje dhe inovacione. Investimet do të realizohen përmes skemës grantuese për të gjithë aktorët turistik, siç janë komunat, institucionet, shoqatat qytetare dhe sektori privat.

Lista për verifikim të planit për menaxhim me mjedisin jetësor (lista për verifikim të PMMJ) bazohet në aktivitetet të cilat do të realizohen në kuadër të nënprojektit „ Rikonstruim dhe mbindërtim i shtegut për këmbësorë - çiklizëm dhe vendpushim “ e locuar në Qendrën e Zhupës - Ishujt e Dibrës. Lista për verifikim të PMMJ përmban përshkrim të projektit, detajeve teknike, vëllimit, dhe vendosjes të lokacionit, në bazë të të cilave kryhet vlerësimi i rreziqeve ekologjike dhe sociale. Realizimi i masave për zbutjen e ndikimeve të cilat kanë të bëjnë me rreziqet dhe problemet e identifikuar, si edhe planin për monitorim të definuar në listën për verifikim të PMMJ janë të obligueshme edhe në pajtueshmëri me standardet nacionale për mjedisin jetësor, rregullativat e tjera dhe politikat operative të Bankës Botërore.

Lista për verifikim, si edhe të gjitha aktivitetet e projektit duhet të jenë në pajtueshmëri me kornizën për menaxhim me mjedisin jetësor e përgaditur për tërë projektin për konkurrencë lokale dhe rajonale.

1. Përshkrim i shkurtër i projektit

Komuna Qendër Zhupë është komunë rurale, e cila tani më ka filluar ta zhvillojë infrastrukturën, në të cilën turizmi fillon të bëhet një ndër prioritetet kryesore. Për zhvillimin e turizmit në komunë, si faktor i rëndësishëm është oferta për disa vende atraktive në të cilët turistët të mund të qëndrojnë të paktën një ditë. Komuna Qendër Zhupë i përket destinacionit numër 6 - Reka, Mavrova dhe rrethina e saj. Ideja e nënprojektit është ndërtimi i një shtegu për biçikleta dhe këmbësorë i cili do të lidhë qendrën e komunës Qendër Zhupë me liqenin e Dibrës dhe i cili në fundin e tij do të ketë një pushimore, gjegjësisht hapsirë të regulluar për pushim, relaksim dhe rekreim për vizitorët. Projekti infrastrukturor për ndërtimin e këtij shtegu tani thuaj se është i përgaditur, dhe lokacioni i përzgjedhur paraqet destinacionin më atraktiv në komunë. Fillimi i shtegut nis që nga hyrja e vendbanimit Qendër Zhupë, kalon një pjesë nëpër Qendër Zhupë dhe takohet me liqenin e Dibrës në afërsi të të ashtuquajturave Ishujt e Dibrës.

Deri tani komuna Qendër Zhupë nuk ka ndërtuar ndonjë shteg për këmbësorë e biçikleta pasi që rruga rajonale dhe rrugët lokale kanë qenë në gjendje shumë të keqe, ashtu që ju dha përparësi sanimit dhe rikonstruimit të tyre. Me ndërtimin e këtij shtegu vizitorëve do t'ju mundësohet që të përfshihen në hulumtimin aktiv të natyrës përmes aktiviteteve në hapsirë të hapur duke shijuar pejsazhet e bukura natyrore gjatë gjithë gjatësisë së shtegut.

Qëllimi i nënprojektit tonë, gjegjësisht ndërtimit të shtegut për këmbësorë dhe biçikleta paraqet zhvillim të turizmit në nivel lokal në Qendrën e Zhupës, krahas saj edhe rritje të përkrahjes dhe zhvillimit në nivel qendror.

Komuna Qendra e Zhupës, gjendet në pjesën perëndimore të Maqedonisë dhe bën pjesë në grupin të komunave rurale, e cila posedon bukuri natyrore prej të cilave vizitorët mahniten. Lokacioni ku do të ndërtohet shtegu dhe pushimorja është i rrethuar me bukuri natyrore, dhe në fund të shtegut do të vendoset pushimore ku turistët vendas dhe të jashtëm mund të ulen të pushojnë, të relaksohen dhe të shijojnë bukuritë natyrore të liqenit të Dibrës.

2. Lokacioni i projektit

- Shtrirja projektuese që është e përfshirë në projekt mbulon pjesën: Komuna e Qendrës Zhupë - Ishujt e Dibrës. Pika fillestare e projektit ndodhet në hyrje të vendbanimit Qendër Zhupë, e njëjta vazhdon drejt një rruge ekzistuese makinash me elemente jo standarde, të njëjtat të pa kategorizuara, me destinacion përfundimtar liqenin e Dibrës, përgjatë rrugës do të ndërtohet dhe do të vendoset një vendpushim. Aktivitetet e projektit nuk janë të parapara në ose pranë ndonjë zone mbrojtur natyrore ose vend të trashëgimisë kulturore.


3. Ndërtimi i shtegut për këmbësorë dhe biçikleta dhe pushimore parasheh:

1. Punë parapërgaditore:

- Shënim dhe sigurim i trasesë
- Pastrimi i terenit nga pemët, shkurret dhe rrënjët.
- Gdhendje makinerike të shtresës ekzistuese të asfaltit 0-5cm me ngarkim dhe transport deri tek në deponinë e mbeturinave

2. Punime dheu:

- Gërmim i dheut dhe transport deri tek deponia
- Gërmim maqinerik i materijalit të dheut me ngarkim dhe transport deri tek deponia
- Planifikim dhe shtypje e shtresës bazë deri tek ngjeshja e nevojshme sipas kushteve teknike.
- Shtruarja e shtresës bazë deri në dendësinë e nevojshme (Ndërtimi i shtresës së mbushur). Ndërtimi i shtresës së mbushur deri tek dendësia që do të thotë vendosje dhe presim i materijalit në pjesët e caktuara, të dizajnuara me profile përgjat linjës, për rafshimin e trasesë para shtrimit të shtresës së asfaltit. Rruga për biçikleta në fillim në një pjesë të vogël kalon paralel me një rrjedhë uji të vogël – lum i cili ka ujë në pranverë. Në disa pjesë të shtegut të biçikletave (në pjesën e fshatit) do të ndërtohet kanal i çimentuar, kurse në pjesët tjera do të ndërtohet drenazh për shtegun e biçikletave. Në fotografinë e më poshtme janë treguar detajet teknike të kullimit.
- Ndërtimi i argjinaturave me mbushje



Skica 1 Detajet teknike të kullimit

3. Shtresa e sipërme

- Ndërtimi i bankinave stabile nga material tamponi
- Blerja, transporti dhe vendosja e shtresës së tamponit nga materijali prej gurit të thyer dedikuar për shtegun e ri të projektuar të biçikletave.
- Spërkatja e emulzionit bitumenik 400gr/m² në asfaltin e vjetër para shtrimit të shtresës së re të asfaltit.
- Blerja, transporti dhe vendosja e shtresës së bitumenit.

4. Paisjet urbane dhe rregullimi parter në sipërfaqe 400 m²

- Pastrimi i terrenit nga bimët sipërfaqësore dhe mbeturinave eventuale dhe hudhja e mbeturinave në deponi në largësi 10 km
- Blerja, transporti dhe montimi i tre verandave, një verandë ka sipërfaqe 50m².
- Blerja , transporti dhe montimi i 16 kandelbarëve solar
- Blerje, transporti dhe montimi i 4 kantave për mbeturina,
- Blerje, transporti dhe montimi i 12 karrikeve për tu ulur ,
- Blerje dhe mbjellje i pemëve pesëvjeçare të blinit
- Blerje, transport dhe shtrim i një shtrese me rërë me d=30 cm, i hapsirës për rekreacion.

4. Kategoria e mjedisit jetësor

PKLR është mbështetur me grant nga Bashkimi Evropian dhe implementohet së bashku me Kabinetin e zëvendës kryetarit të qeverisë të ngarkuar për problemet ekonomike, Njësinë për realizimin e projekteve dhe Bankës Botërore.

PKLR është klasifikuar si projekt i Kategorisë B, që mund të priten ndikime të vogla mbi mjedisin jetësor gjatë realizimit të projektit, asnjëra prej atyre ndikimeve nuk do të jetë e theksuar, e madhe apo afatgjate.

Si rezultat i këtij klasifikimi, politika operative PO4.01 - Aktivizohet vlerësimi i mjedisit jetësor. Radhazi, Kabineti i zëvendëskryeministrit të qeverisë i angazhuar për çështjet ekonomike (KZKQAPE) përgaditi Kornizë për menaxhim me aspektet sociale dhe mjedisin

jetësor (KMASMJ) me qëllim që të jepen udhëzime për përgaditjen e analizës ekologjike të nënprojekteve të mbështetura nga Komponenta 3 nga skema grantuese, të definohet pajtueshmëria dhe procedurat për skringing dhe vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor. Të gjitha aktivitetet e projektit (dhe nënprojektet) duhet të realizohen në pajtueshmëri me Kornizën për menaxhim me aspektet sociale dhe mjedisin jetësor (KMASMJ). Politikat operative dhe procedurat e Bankës Botërore dhe regullativës Nacionale (mbizotëron më e larta).

Nënprojekti i propozuar, ndërtim i shtegut këmbësorik dhe për biçikleta dhe pushimore klasifikohet si i Kategorisë B-, duke pasur parasysh në atë që ndikimet e pritura në mjedisin jetësor janë më pak të dëmshme se ndikimet e nënprojekteve të kualifikuara si të Kategorisë A dhe kategorisë B+, duke pasur parasysh natyrën e tyre, madhësinë dhe lokalitetin si dhe karakteristikat e ndikimeve potenciale në mjedisin jetësor.

Kjo kategori e nënprojektit kërkon vlerësim të aspekteve sociale dhe mjedisit jetësor (VASMJ) me qëllim që të vlerësohen ndikimet potenciale në mjedisin shoqëror të lidhura me realizimin e nënprojektit, të përcaktohen mundësitë potenciale për përmirësimin e mjedisit jetësor dhe të rekomandohen masa të nevojshme për pengimin, minimizimin dhe amortizimin e ndikimeve të dëmshme. Vëllimi dhe forma e VASMJ varet prej nënprojektit konkret, por më së shpeshti është mëi vogël se vëllimi i vlerësimit të përgjithshëm të ndikimeve ndaj aspekteve sociale dhe mjedisit jetësor (VASMJ), zakonisht në formë të planit për menaxhim me aspektet sociale dhe mjedisin jetësor (PMASMJ).

Vëllimi i PMASMJ definohet në pjesën E të Formularit për kërkesën e përgjithshme dhe në aneksin G të PMASMJ.

Për nënprojektet të cilat parashohin ndërtime të thjeshta, rindërtim apo adoptim të objekteve, parashihet shfrytëzim i listës për verifikim për PMASMJ

(Pjesa nga formulari i përgjithshëm ose Aneksi F nga PMASMJ)

Në Kategorinë B- gjithashtu përfshihen nënprojektet të cilat: () përfshijnë grante të cilat parashohin blerje dhe/ose shfrytëzim të materijaleve të rezikshme (p.sh. benzin) ose (b) parashohin përmirësime të cilat përfshijnë blerje të paisjeve/mekanizimit e cila paraqet rrezik potencial për shëndetin dhe sigurinë. Në pajtueshmëri me ligjet maqedonase, për nën projektet të cilat i takojnë kategorisë B- nuk është e nevojshme të pregaditet Vlerësim të ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor (VNMJ).

5. Shqyrtim i ndikimeve të mundshme

Në këtë kapitull janë të përshkruara ndikimet nga aktivitetet e parashikuara gjatë Rikonstruimit dhe mbindërtimit të shtegut për këmbësorë - çiklizëm dhe pushimore, sektori Qendër Zhupë - Ishujt e Dibrës si dhe funksionimi i saj me qëllim që ato të identifikohen, të radhiten sipas intenzitetit dhe kohëzgjatjes, sasisë të emitimit të materijaleve ndotëse, shkaktimit të mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta, dhe të japin kahje të drejta për sjelljen e masave për ndikimet eventuale negative.

Sipas karakteristikave, qëllimi dhe lokaliteti i projektit të propozuar, i njëjti nuk ka ndikime negative më tërëndësishme ndaj mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve.

Përvojat dhe praktika e mëparshme për ndërtim, rehabilitim dhe rindërtim në Republikën e Maqedonisë tregojnë se ato pasqyrohen në këto aktivitete:

- Përcaktimi i shtrirjes së saktë të shtegut. Në këtë rast rruga përcaktohet sipas shtrirjes ekzistuese. Megjithatë, si pasojë e këtij procesi, mund të ndodhin aktivitete të tilla si: degradimi i vegjetacionit, ndryshimet në cilësinë e sipërfaqes dhe ujërave nëntokësore në rast të derdhjes aksidentale të substancave të dëmshme (lëndë djegëse, vaj, yndyrat, etj.) rritja e emitimit të gazrave të djegies në ajrin e ambientit, gjenerimin e mbeturinave dhe zhurmës.
- Nga lokacionet e përkohshme të parashikuara për ruajtjen e materialit prej dheu nga gjermimi dhe për argjinaturë, prerje dhe mbushje shpesh mbeten të ashtuquajturat deponi të mbeturinave të cilat pas përfundimit të aktiviteteve ndërtimore duhet të hiqen menjëherë.
- Ndikimi ndaj mjedisit jetësor nga aktivitetet ndërtimore si dridhje dhe zhurmë nga mekanizmat ndërtimore, emitim të pluhurit, mbushjen e shtratit të lumenjve etj.

Karakteristikat e ndikimeve të mundshme:

- Duke pasur parasysh vëllimin e aktiviteteve ndërtimore dhe gjendjen me mjedisin themelor dhe sferën e mjedisit jetësor në afërsi të shtegut për këmbësorë - çiklizëm dhe pushimore, në pajtueshmëri me të dhënat e nxjerra nga dokumentet relevante (PLVM, NEAP, rrjeta lokale dhe shtetërore për monitorim), nuk priten ndikime negative ndaj mjedisit jetësor të cilat kërkojnë masa më të rëndësishme për mbrojtje.
- **Shkarkime në ajër:** shkalla e emitimit dhe kohëzgjatja e aktiviteteve ndërtimore të parapara gjatë ndërtimit të shtegut për këmbësorë - çiklizëm dhe pushimore, nuk do të ndikojnë negativisht ndaj ekosistemit natyror deri në masë për marjen e aktiviteteve plotësiere për reduktim të emisioneve. Duke pasur parasysh gjatësinë e shtegut të paraparë mund të konkludojmë se aktivitetet e projektit nuk do të kenë ndikim të theksuar në rrymimin e erërave lokale dhe ndaj mikro klimës dhe bashkësive urbane.
- **Krijimi i mbeturinave:** mbeturinat nga aktivitetet gjatë ndërtimit të shtegut për këmbësorë e biçikleta dhe pushimore do të jetë i llojllojshëm nga struktura. Krijimi i mbeturinave nga aktivitetet ndërtimore është potencijal për ndotjen e ambientit. Pothuajse i gjithë materijali i krijuar do të jetë inert dhe do të krijohet në fazën e ndërtimit. Sipas listës së llojeve të mbeturinave, pjesa më e madhe e mbeturinave të gjeneruara prej aktiviteteve të projektit është kategorizuar si mbeturina ndërtimore dhe mbeturina nga shkatërimi, si dhe prodhim i sasive të vogla të mbeturinave të rrezikshme p.sh. Derdhje e rastësishme e vajit makinerik, lubrifikantëve, lëndëve djegëse dhe paqetimet tjera të kontaminuara. Blerja dhe instalimi i një këndit të lojrave dhe paisjes urbane mund të krijojë mbeturina tëparezikshme (letra, karton, plastikë dhe materijale tjera sintetike) për shkak të mbeturinave nga paketimi.

Mbeturinat inerte të cilat do të prodhohen është karakterizuar si mbeturina të pa rrezikshme. Nuk ka ndikim negativ mbi mjedisin jetësor, por është e domosdoshme që të ketë lokacion ku do të hidhen mbeturinat. Mbeturinat inerte (p.sh. dheu, betoni, gurrët e thyer dhe pllakat etj.) mund të mbulojë sipërfaqe të mëdha dhe mund ta prishë atë pjesë. Pjesa më e madhe e dheut të gjermuar do të shfrytëzohet për nivelizim dhe do të deponohet për sipërfaqe të përkohshme.

Sasitë e mbeturinave do të ishin minimale nëse ka menaxhim të mirë me mbeturinat, duke përdorur teknikat më të mira të disponueshme për zvogëlimin e mbeturinave në

kohën e fazës ndërtimore dhe aplikative. Kontraktuesi është i obliguar për t'u marrë me mbeturinat që do të krijohen gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit.

- **Shkarkimet në tokë dhe ujë:** duke pasur parasysh faktin se një pjesë e shtegut në lokacionin e caktuar zgjatet në hapsirë pak të urbanizuar (f. Papranik i Madh), efekti mbi ekosistemet ekzistuese përreth loacionit prej punëve ndërtimore nuk ekziston, gjegjësisht nuk do të ketë fragmentizim e me ta as edhe efekte negative. Ndotja e vogël është e mundur në rast të rrjedhjes së karburanteve ose vajrave. Erozioni i tokës është i mundur gjatë ndërtimit të argjinaturave. Duke pasur parasysh numrin e vogël të aktiviteteve ndërtimore dhe sipërfaqes së vogël që përfshihet, nuk priten ndikime të rëndësishme negative në tokë, gjeologji dhe ndikim në topografinë lokale.
- **Zhurma, dridhjet dhe rrezatimi jonizues:** Shfaqja e zhurmës nga automjetet e kontraktorit gjatë punës do të ketë shumë pak ndikim negative, për shkak të faktit se do të ketë kohëzgjatje të kufizuar dhe karakter lokal. Emetimet e zërit do të jenë të parëndësishme nëse kontraktori përdor automjete dhe makina ndërtimi në përputhje me standardet teknike dhe punimet e ndërtimit që do të kryhen gjatë ditës (prej orës 7 deri në 19). Ndikimi i vibracioneve do të minimizohet me përdorimin e makinizimit me mjete të vendosura për amortizim. Megjithatë efektet e vibrimit do të jenë të kufizuara në kohëzgjatjen e aktiviteteve të punës (8 deri 10 orë në ditë) dhe nuk ka potencial për të shkaktuar ndikim negative afatgjatë në shëndetin e njeriut dhe të mirave materijale në hapsirën e afërt të shtegut projektues. Në fazën e vendosjes së infrastrukturës nuk priten ndikime negative në mjedisin jetësor të nxitura nga emitimi i zhurmës dhe dridhjeve.
- **Ndikimi ndaj biodiversitetit:** Në lokalitetin ku do të kryhen aktivitetet e caktuara në fazën e ndërtimit si edhe në fazën e shfrytëzimit nuk do të vjen deri tek ndryshime më të mëdha të përhershme të karakteristikave të pejsazhit.

6. Qëllimi i listës për verifikim për PMASMJ

Banka Botërore kërkon vlerësim të mjedisit jetësor për projekte të propozuara për financim nga Banka Botërore, me qëllim të sigurohet se ata janë të qëndrueshme nga aspekti ekologjik dhe me atë ta përmirësojnë procesin e sjelljes së vendimeve. është proces gjërësia e saj, thellësia dhe lloji i analizës varen prej natyrës, vëllimit dhe ndikimeve potencijale ndaj mjedisit jetësor të projektit të propozuar.

Vlerësimi i mjedisit jetësor i vlerëson rreziqet e mundshme ekologjike të projektit, si edhe ndikimet e tyre në vendin e përfshirë të projektit.

Sipas skrinimit të kërkesës për shprehje të interes, duke kyçur edhe pyetëtorin për mjedisin jetësor, nën-projektin, Rikonstruim dhe mbindërtim i shtegut për këmbësorë - çiklizëm dhe vendpushim,, i locuar ne Qendër Zhupë - ishujt e Dibrës, u kategorizua si B-.

Nën-projektete të cilat janë të kualifikuara të kategorisë B- , ndikimet potencijale ndaj mjedisit jetësor janë shumë pak të dëmshme nga nën-projektet të kategorive A dhe B+, duke pasur parasysh natyrën e tyre, madhësinë dhe loaklitetit, si edhe karakteristikat potencijale ndaj mjedisit jetësor.

Lista për verifikim për PMASMJ përdoret për aktivitete më të vogla për rikonstruim ose ndërtim të objekteve të reja të vogla. Ajo mundëson “praktika të mira pragmatike “dhe është i dizajnuar të jetë i lehtë për përdorim dhe kompatibil në kërkesat për mbrojtje të mjedisit jetësor të Bankës Botërore. Format i Listës për verifikim tenton ti përfshijë qasjet tipike për minimizimin e ndikimeve ndaj mjedisit jetësor tek të gjitha marëveshjet për punë

ndërtimore me ndikime lokale.

Lista për kontroll ka sjellë seksion (pjesë hyrëse në kornizat në të cilën nën-projekti është i përshkruar, pjesa ku është definuar kategoria ekologjike dhe janë të identifikuar ndikimet e nënprojekteve ndaj mjedisit jetësor, dhe pjesa ku është spjeguar koncepti i planit për menaxhim me aspektet sociale dhe mjedisin jetësor) dhe tre pjesë kryesore, edhe atë:

- **Pjesa 1** e permban pjesën përshkruese ("pasaporta e objektit") në të cilën përshkruhen specifikat e nënprojektit, lidhur me lokacionin fizik, aspektet institucionale dhe juridike, përshkrimi i nënprojektit, duke përfshirë edhe nevojën për program për ndërtim të kapaciteteve dhe përshkrimin të procesit të konsultimit publik në lidhje me projektin.
- **Pjesa 2** e përfshin skringun ekologjik dhe social në format të thjeshtëzuar
- Po/Jo, I ndjekur me masat për zbutjen e çdo aktiviteti; dhe
- **Pjesa 3** e planit për monitorim të aktiviteteve gjatë kohës së ndërtimit dhe raelizimit të nënprojektit.

Procedura për publikimin e listës së kontrollit të PMMJ-së është si më poshtë: Lista për verifikim të PMMJ-së do të publikohet në faqen e internetit të PKLR -së, si dhe në faqen e internetit të komunës së Zupës. Do të jetë në dispozicion të publikut për të paktën 14 ditë. Duhet të jetë në dispozicion në kopje e shtypur në ambientet e PKLR -së dhe të komunës së Qendrës Zupë dhe Agjencionit për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit. Kur të publikohet lista e kontrollit të PMMJ, do të publikohet një thirrje për paraqitjen e komenteve mbi dokumentet, së bashku me adresën elektronike dhe postare për të dërguar komente dhe vërejtje. Procesverbalet e konsultimit publik të mbajtur (komentet dhe pyetjet e grumbulluara) e përmbajnë informacionin bazë për vendin, listën e pjesëmarrësve dhe një përmbledhje të shkurtër të vërejtjeve të marra që duhet të përfshihen në versionin përfundimtar të dokumentit të botuar.

7. Aplikacioni i listës PMMJ

Lista PMMJ është një dokument i përgatitur dhe në pronësi të Komunës së Qendrës Zupë. Procesi i projektimit për projektin e paraparë në nënprojektin "Rikonstruim dhe mbindërtim i shtegut për këmbësorë - çiklizëm dhe vendpushim" do të zhvillohet në tri faza:

1. Identifikimi i përgjithshëm dhe faza e prerjes, në të cilën ndërtimi është shënuar edhe spjeguar programi i përafërt për tipologjitë e mundshme të punës. Në këtë fazë seksionet 1, 2 dhe 3 të listës EMO. Lista EMO mund të përdoret për të treguar aktivitetet tipike nga "menyja" dhe të lidhen me çështjet tipike mjedisore dhe masat zbutëse. Është e nevojshme të zhvillohet një konsultim publik në lidhje me listën e kontrollit të PMMJ dhe të përmbillet dokumenti.

2. Faza e planifikimit të hollësishëm dhe të tenderimit, duke përfshirë përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vlerësimet e kostos për punën e ndërtimit, specifikimet e pajisjeve, specifikimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të marketingut për nevojat e nënprojektit. Pjesa tabelare plotësisht e plotësuar nga Lista për kontroll e PMMJ (pjesa 1, 2 dhe 3) duhet ti bashkëngjitet marëveshjes për furnizim publik të punëve, marëveshja për mbykqyrje profesionale, analog me atë edhe i të gjithë marëveshjeve teknike dhe komercijale të cilat patjetër duhet të nënshkruhen na të dyja palët.
3. Në fazën e realizimit të punëve ndërtimore, realizuesi e realizon planin për monitorim dhe masat për minimizimin na lista për kontroll për PMMJ, përderisa përshtatshmëria e nënprojektit me mjedisin jetësor (me listën për kontroll PMMJ dhe regulativës së zgjeruar për mbrojtjen e mjedisit jetësor, sigurinë dhe shëndetin) dhe kriteret e tjera kualitative realizohet në vetë lokacionin e ndërtimit nga ana e mbikqyrjes profesionale të punëve ndërtimore ose organit mbikqyrës të nënprojektit.

Masat për minimizim janë të specifikuar në Pjesën 2 dhe planin për monitorim nga Pjesa 3 janë bazë në të cilën duhet të vërtetohet se a i ka përmbushur realizuesi dispozitat e kërkuara për mbrojtjen e mjedisit

Zbatimi praktik i listës së kontrollit të PMMJ do të thotë përmbushja e kërkesave të Pjesës 1 duke patur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe lejet e ndërtimit. Në pjesën e dytë, aktivitetet që duhet të realizohen duhet të kontrollohen në bazë të llojit specifik të aktivitetit, dhe në pjesën e tretë identifikimi i parametrave të monitorimit (nga Seksioni 3) duhet të zbatohet në përputhje me aktivitetet e paraqitura në Seksionin 2.

Dokumenti përfundimtar në listën e kontrollit të PMMJ do të bashkëngjitet si pjesë përbërëse e kontratave të punëve publike, si dhe të gjitha kontratat teknike dhe tregtare dhe ato duhet të nënshkruhen nga të dyja palët kontraktuese.

8. Masat për zbutje

Masat që të eliminohen/zbuten ndikimet ndaj mjedisit jetësor, punëtorëve dhe bashkësive, si edhe aspektet shoqërore të nënprojektit që do të duhen të përdoren në kornizat e nënprojektit janë ata rrjedhëse, por nuk janë të kufizuara vetëm në ato për sa vijon: Shënim përkatës i lokacionit për rekonstruim, shënim përkatës i lokacionit për rruajtjen e përkohshme të materialit ndërtimor në lokacion, sigurim i shiritave paralajmëruese, gardhe dhe shenja, ndalim i hyrjes për persona që nuk punojnë me shiritat paralajmërues. Respektim të masave për sigurinë e qytetarëve, me maqineritë duhet të punojë vetëm personel me eksperiencë dhe i trajnuar, prani të përhershme të aparatave zjarrfikëse në rast të zjarrit ose dëmi tjetër, mbajtje e përhershme e paisjeve dhe veshjeve mbrojtëse, fiksimi i skeleve dhe masa tjera për siguri dhe shëndet. Lëndët djegëse duhet të ruhen vetëm në enët e dizajnuara për atë qëllim.

Të gjithë punëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se rreziqet nga zjarri dhe masat kundër zjarrit, edhe duhet të jenë të trajnuar që ti përdorin aparatet kundër zjarrit, hidrantet dhe aparatat tjera të cilat përdoren për shuarjen e zjarrit të cilat duhet të jenë funksionale.

Niveli i zhurmës nuk duhet të kalojë 55 dB gjatë ditës, kurse punë nuk duhet të kryhen

gjatë natës (orari i punës do të jetë prej orës 07 deri në ora 19). Caktimi, klasifikimi dhe deponimi përkatës i përkohshëm (në kanta/kontejnerë për mbeturina veçanta të shënuara qartë në lokacione të posaçme që më parë të caktuara, dhe në numër të mjaftueshëm) të llojeve të ndryshme të mbeturinave që mund të formohen nga renovimi, si edhe menaxhim i drejtë me mbeturinat. Mbeturinat mund të transportohen dhe deponohen/përpunohen vetëm nga kompani të licencuara.

Të vendoset regjim i posaçëm për automjetet e realizuesit gjatë kohës së rinovimit, me sinjalizim përkatës. Nënshkrimi i marëveshjes me kompaninë shërbyese për mirëmbajtje të vazhdueshme, ndrimin e pjesëve rezervë, ndrimet preventive të vajrave, mirëmbajtje përkatëse (gazrat lëshuese dhe siguria, psh. frena, goma etj.) si një prej funksioneve më të rëndësishme të sigurisë, etj., larja e rregullt e makinave dhe mbajtja e pastër e parkingut, ndalimi i ndrimin të vajit ta makinave në parking që ti largohet ndotjes së ujit dhe tokës, të kryhet testim vjetor për miratim për kohën e regjistrimit të automjeteve.

Masat për zbutjen e ndikimeve të përshkruara në këtë pjesë janë masat e obligueshme detale për zbutjen e ndikimeve të cilat janë dhënë në tabelën për zbutjen e ndikimeve (pjesa 3).

9. Monitorim dhe Lajmërim

Për monitorimin e masave për mbrojtje të cilat i ralizojnë realizuesi, mbykqyrësi profesional mbi punët ndërtimore ose personi i autorizuar nga Komuna Qendër Zhupë (në rast të punëve kur nuk duhet të angazhohet mbykqyrje profesionale) do të punohet në pajtueshmëri me Pjesën 2 dhe 3 nga dokumenti lista për kontroll për planin PMMJ, gjegjësisht planit për monitorim. Pjesët 2 dhe 3 janë zhvilluar në detaje të nevojshme dhe me masa precize për zbutjen e ndikimeve dhe monitorim të cilat duhet të përfshihen në marëveshjet për furnizime publike të punëve të cilate reflektojnë statusin e praktikave të mira ekologjike në vendin e punës, dhe të cilat mund të vërehen, maten dhe kontrollohen nga ana e personave mbykqyrës gjatë kohës së realizimit të punëve ndërtimore.

Këto masa për zbutjen e ndikimeve përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në përdorimin e paisjeve për mbrojtje personale dhe veshje mbrojtëse të punëtorëve në çdo kohë; preventivë dhe pengim të ngritjes së pluhurit; zvogëlim të sasisë së ujit për përdorim dhe derdhje; pastrim i ujrave derdhëse, sigurimi i kushteve sanitare për punëtorët, mbledhje dhe ndarje të llojeve të mbeturinave (dru, metale, plastikë, material i rrezikshëm si për shembull mbetje nga ngjyrat, vaj makinerik i djegur) në kontejnerë të posaçëm të shënuara, të vendosura në vendet e caktuara në lokacionin e ndërtimit në numër të mjaftueshëm; evidentimi i sasisë së mbeturinave; organizim i drejtë i transportit dhe largimit të mbeturinave; ripërdorim dhe reciklim i mbeturinave kur është e mundur. Mbeturinat mund të transportohen dhe hudhen vetëm në deponi të menaxhuara nga kompani të licencuara.

Përkaj Pjesës 3, organi mbykqyrës i vendit të ndërtimit duhet të kontrollojë a i plotëson realizuesi masat për zbutjen e ndikimeve nga Pjesa 2. Lajmërimi për realizimin e procedurave dhe praktikave duhet të jetë i përshkruar në raportin e rregullt deri te Njësia për realizimin e projektit.

Realizimi i masave për zbutjen e ndikimeve duhet të monitorohen para fillimit të punëve, gjatë kohës së ndërtimit të shtegut dhe pas mbarimit të saj. Masat e definuara për

kontroll për PMMJ do të ndiqen nga inxhinieri mbykqyrës; Komuna Qendër Zhupë (inspektori komunal dhe të punësuarit në Njësinë për urbanizëm dhe zhvillim ekonomik lokal) të cilët njëkohësisht janë edhe anëtarë të ekipit të projektit, si edhe ekspertit të mjedisit jetësor të angazhuar nga Njësia për implementimin e projektit. Raporti i pranuar për monitorim i punar nga ana e realizuesit ose organit mbykqyrës të vendit të ndërtimit do të jetë bazë për pagesën e përgjithshme të pagesave sipas marëveshjes, si edhe raporti nga hulumtimet teknike prej të cilave do të vërtetohet a janë të plotësuara kriteret teknike për kualitet të punëve. Lajmërimi për përdorimin e listës për kontroll për PMMJ do të jetë kuartal. Që të sigurohet se realizuesi do të implementojë masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, posaçërisht klauzula do të futet në marëveshjen me të cilën do të shkruhen dënime në raste të mos respektimit të dispozitave mjedisore të dakorduara, p.sh: mbajtja e një pjese të pagesës derisa nuk kryhen masat korektuese në pajtueshmëri me nënprojektin, kurse sasia e mbajtjeve do të varet prej seriozitetit të lëndimit të marëveshjes. Për rastet ekstreme, e drejta për ndërprerje të marëveshjes do të shënohet në marëveshje.

Aplikanti ka obligim që vazhdimisht të dorëzojë tre raporte mujore për realizimin e listës për kontroll për PMMJ dhe monitorim të masave për zbutjen e ndikimeve në formë të pasqyrës tabelare (tabela për planin për monitorim dhe tabela për planin për masat e zbutjes së ndikimeve) me kolonë plotësuese për statusin e masave, vërejtje dhe komentare, dhe monitorim të masave (e realizuar/i pa realizuar, rezultate, vërejtje, komente, shqetësime dhe ngajshëm).

Pjesa1: ASPEKTET INSTITUCIONALE DHE ADMINISTRATIVE	
Vendi	Republika e Maqedonisë
Emri i projektit	Rikonstruim dhe mbindërtim i shtegut për këmbësorë - çiklizëm dhe vendpushim
Vëllimi nënprojektit dhe aktivitetet konkrete	Menxhimi dhe koordinimi i nënprojektit Rikonstruim dhe mbindërtim i shtegut për këmbësorë - çiklizëm dhe vendpushim; Vendosja e paisjeve urbane dhe rregulli i argjinaturave
Vendosja institucionale (Emri dhe kontakti)	Menaxhim me projektin* <u>Investues:</u> Komuna Qendër Zhupë Telefon:046/840-239 -mail: merkezjupa@hotmail.com
Vendosja realizuese	<u>Koordinator i projektit:</u> Muharem Imerovski Telefon:070/ 594-447 -maili: imerovskim@gmail.com <u>Realizues:</u> Do të përcaktohet pas përfundimit të procedurave për dhënien e kontratave të prokurimit publik për nevojat e nën-projektit Mbykqyrja***(Pas përfundimit të procedurës, emri dhe kontaktet e inxhinierit mbikëqyrës do të shtohet në fushën e mëposhtme)

PËRSHKRIMI I LOKACIONIT	
EMRI I LOKACIONIT	Seksioni Qendër Zhupë - Ishujt e Dibrës

Përshkrimi i lokacionit	Shtegu i lëndës e cila është përfshirë në këtë projekt e përfshin sektorin Qendër Zhupë-ishujt e Dibrës. Pika fillestare është e locuar në hyrje të vendbanimit të Qendër Zhupë e njehta vazhdon nëpër një rrugë makinash me elemente të pa standardizuara me destinacion përfundimtar Liqeni i Dibrës përgjatë shtegut do të vendoset pushimore.	Aneks 1: Informatë për lokacionin (Fotografi nga lokacioni)[X]P[]J
Kush është pronar i tokës?	R. e Maqedonisë	
